



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MEMALIAJ
KRYETARI

Memaliaj, më 29 . 10 . 2025

NJOFTIM

PËR

APLIKIME PËR TË PËRFITUAR NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT

Të nderuar qytetarë,

Në mbështetje të ligjit Nr.22/2018 "Për strehim social", VKM Nr.384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe afateve të procedurave të miratimit në organet e vetqeverisjes vendore për një nga programet e strehimit" si:

- Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfra dhe të pafavorizuara.
- Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë;

Ju informojmë se Bashkia Memaliaj ka hapur fazën e parë të aplikimeve që konsistojnë në dorëzimin e kërkesave sipas programeve për të cilat jeni të interesuar, së bashku me dokumentacionin përkatës.

Kërkesa duhet të dorëzohet në Zyrën me një ndalesë pranë Bashkisë Memaliaj ose në çdo njësi administrative.

NË FAZËN E PARË: Aplikantët paraqesin kërkesën e tyre për të përfituar nga programet e strehimit social, sipas ligjit nr. 22/2018, duke paraqitur dokumentacionin përkatës brenda datës **14 nëntor 2025, ora 16:00**. Pas këtij afati nuk do të merret në konsideratë asnjë kërkesë e ardhur.

Kujdes! NË FAZËN E DYTË: Përfshihen vetëm ata/o individë/familje që janë përzgjedhur nga Komisioni i Strehimit për t'u trajtuar me njërin prej programeve të strehimit dhe plotësojnë të gjitha kushtet dhe kriteret për tu kualifikuar.

Për çdo informacion ose paqartësi mund të drejtoheni pranë Bashkisë Memaliaj!

